

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenet 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit

621-26-4068-2-2-1

Sa i përket tenderit për: **021- Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës së Dragashit – 24 Muaj**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

“PROing&Partners”SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

K.Dielli, Major M. Bushi Lam. 12/11 Z. e Perëndimit

(Adresa)

Prishtinë

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

048 313 525

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Vadet Zena

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

proing2005@gmail.com

(Adresa elektronike)

12.08.2026

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 29.05.2026

Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 29.06.2026

Kriteri për dhënie ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me poentim

Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 29.07.2026

Kërkesa për rishqyrtim dt:03.08.2026

Vendimi i AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt. 05.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Jemi njoftuar përmes sistemi elektronik e-prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Bashkëngjitur e gjeni vendimin e AK lidhur me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 1 Qëllimi
- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët
- Neni 64 Dëshmitë e kërkesave
- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Nenin 41.6 të Rregullores Nr. 001/2022
- Vendimet e panelit shqyrtues: me nr. PSH 1034/23, datë 07.02.2024, PSH 2024/0431, datë 03.07.2024, PSH 2024/0674, datë 25.09.2024

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Duke marrë parasysh se Kërkesa për Rishqyrtim e paraqitur nga "PROing&Partners" SH.P.K. më datë 03.08.2026 pranë Autoritetit Kontraktues – KUVENDI I KOMUNËS DRAGASH, është refuzuar, me këtë parashtrojmë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Më datë 29.07.2026, përmes platformës elektronike të prokurimit publik, jemi njoftuar nga Autoriteti Kontraktues për vendimin lidhur me tenderuesin e pasuksesshëm, ndërsa për dhënie të kontratës është rekomanduar Grupi i Operatorëve Ekonomikë:

STUDIO HAPSIRA SHPK & SEMAKS SHPK & DEA GROUP SHPK & GEOPLAN & CONSULTING GROUP SHPK.

Më datë 30.07.2026 kemi ushtruar të drejtën e qasjes në dokumentet e ofertës së Grupit të Operatorëve Ekonomikë të rekomanduar për kontratë dhe, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, kemi konstatuar një numër të mospërputhjeve të cilat, sipas vlerësimit tonë, ndikojnë drejtpërdrejt në përgjegjshmërinë e ofertës.

Për këto arsye parashtrojmë pretendimet ankimore si në vijim.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 1

Oferta e GOE të rekomanduar për kontratë përmban pozicione me çmime jo-normalisht të ulëta dhe sqarimet e dhëna nuk dëshmojnë realizueshmërinë e këtyre çmimeve

Në pajtim me nenin 61.4 të Ligjit për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar, si dhe nenin 41.6 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues, në rastet kur një tender duket të jetë jo-normalisht i ulët, është i obliguar të kërkojë sqarime dhe të vlerësojë në mënyrë substanciale bazën ekonomike të ofertës.

Në rastin konkret, nga dokumentet në të cilat kemi pasur qasje rezulton se GOE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar çmime jo-normalisht të ulëta në një numër të konsiderueshëm pozicionesh, përfshirë:

- Pozicioni I.A.1 ka vendosur çmimin 0.03€/m²
- Pozicioni I.A.2 ka vendosur çmimin 0.03€/m²
- Pozicioni I.A.3 ka vendosur çmimin 0.03€/m²
- Pozicioni I.A.4 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.A.5 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.A.6 ka vendosur çmimin 0.01€/m²

- Pozicioni I.A.7 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.A.8 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.A.9 ka vendosur çmimin 0.05€/m²
- Pozicioni I.B.2 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.B.3 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.B.4 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.B.5 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.B.6 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.B.7 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.C.2 ka vendosur çmimin 0.01€/m
- Pozicioni I.C.3 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.C.5 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.C.6 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.C.7 ka vendosur çmimin 0.01€/m
- Pozicioni I.C.8 ka vendosur çmimin 0.01€/m
- Pozicioni I.C.9 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.C.11 ka vendosur çmimin 0.01€/m
- Pozicioni I.D.1 ka vendosur çmimin 0.10€/m
- Pozicioni I.D.2 ka vendosur çmimin 0.10€/m
- Pozicioni I.D.3 ka vendosur çmimin 0.01€/m
- Pozicioni I.D.4 ka vendosur çmimin 0.01€/m³
- Pozicioni I.D.5 ka vendosur çmimin 0.01€/m
- Pozicioni I.D.6 ka vendosur çmimin 0.01€/m³
- Pozicioni I.D.7 ka vendosur çmimin 0.01€/m
- Pozicioni I.D.8 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.D.9 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.E.1 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.E.2 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.E.3 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.E.4 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.E.5 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.E.6 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.E.7 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.E.8 ka vendosur çmimin 0.01€/m²

Pas qasjes në dokumente kemi parë që Autoriteti kontraktues i ka kërkuar sqarime shitesë për pozicionet e lartëcekura, për të cilat komisioni ka kërkuar nga Zyrtari i Prokurimit që në harmoni me nenin 3.2 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulet dhe duke u bazuar në nenin 41.6 të Rregullores NR.001/2022 të kërkojë sqarim shitesë të GOE të rekomanduar për kontratë rreth çmimeve të ofruara.

Brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues, Grupi Operatoreve Ekonomikë (GOE) i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar sqarimet dhe arsyetimet e kërkuara lidhur me çmimet e ofertuara. Në sqarimet e GOE të rekomanduar për kontratë thuhet se ka realizuar kontrata të ngjashme në të kaluarën me autoritetin kontraktues dhe në bazë të këtyre sqarime autoriteti kontraktues ka vlerësuar se oferta nuk është jonormalisht e ulët dhe e ka rekomanduar për kontratë. Komisioni i Vlerësimit ka shqyrtuar të gjitha sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur, dhe i ka marrë për bazë sqarimet e GOE dhe e ka rekomanduar për kontratë

Ne mendojmë se arsyetimet e dhëna nga Grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë me arsyetimet se ka realizuar kontrata të ngjashme në të kaluarën, përfshirë kontrata me Autoritetin Kontraktues, nuk është vendimtar për vlerësimin e kësaj procedure të

prokurimit. Çdo procedurë zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe vlerësimi bëhet mbi bazën e dokumentacionit dhe ofertës së paraqitur në procedurën konkrete. Përvoja e mëparshme nuk përbën në vetvete provë se çmimet e ofertuara në këtë procedurë janë të realizueshme. Çdo procedurë e prokurimit ka karakteristikat e veta specifike, ndërsa Komisioni i Vlerësimit është i obliguar të vlerësojë secilën ofertë mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar, kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe dispozitave të zbatueshme ligjore.

Nga analiza e këtyre pozicioneve rezulton se çmimet e ofertuara janë në nivele simbolike dhe nuk pasqyrojnë koston reale të angazhimit të stafit profesional, analizave teknike, projektimit, koordinimit, kontrollit të cilësisë dhe përgjegjësiwe profesionale që kërkohen për realizimin e këtyre shërbimeve.

Në rastin konkret, sqarimet e paraqitura nuk arrijnë të dëshmojnë se si shërbime profesionale të kësaj natyre mund të realizohen me çmime prej 0.01 €, 0.02 €, 0.04 € apo 0.05 €, pa cenuar realizueshmërinë e kontratës.

Në veçanti, për çmime prej 0.01 €, 0.02 €, 0.03 € dhe 0.05 €, do të duhej të dëshmohej në mënyrë konkrete se si mbulohen së paku:

- angazhimi i stafit profesional;
- orët e punës dhe personeli i nevojshëm;
- analizat dhe përpunimi teknik;
- shërbimet e projektimit;
- puna në terren;
- pajisjet dhe mjetet teknike;
- shpenzimet operative;
- shpenzimet administrative;
- kostot fikse;
- detyrimet tatimore dhe shpenzimet tjera të aplikueshme; dhe
- kostoja reale e realizimit të secilit pozicion.

Në pajtim me nenin 41 të Rregullores Nr. 001/2022, vlerësimi i një tenderi jo-normalisht të ulët nuk mund të mbështetet vetëm në një arsyetim të përgjithshëm, por duhet të analizohet baza ekonomike e ofertës dhe elementet përkatëse të saj.

Pas shqyrtimit të ofertës, përshkrimit të çmimeve, analizës së tregut dhe sqarimeve të dorëzuara nga GOE të rekomanduar për kontratë Autoriteti Kontraktues është dashur ta eliminojë këtë GOE pasi që ekzistojnë prova dhe indikacione të mjaftueshme që oferta përmban çmime jo-normalisht të ulëta në një numër të konsiderueshëm pozicionesh, të evidentuara në analizën e çmimeve dhe në kërkesën për sqarime.

Ne mendojmë se, pas shqyrtimit të argumenteve të paraqitura në përshkrimin e çmimeve, ka prova të mjaftueshme që oferta e GOE të rekomanduar për kontratë është ofertë me çmime jo-normalisht të ulëta. Në harmoni me Ligjin për Prokurim Publik të Kosovës, veçanërisht në bazë të **nenit 41.6** të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022, dhe vendimeve të mëparshme të Panelit Shqyrtues, autoriteti kontraktues është dashur të konstatoi se oferta në fjalë e GOE të rekomanduar për kontratë është ofertë me çmime jo-normale të ulëta në shumë pozicione të cilat janë evidentuar në Përshkrim të Çmimeve.

Gjatë marrjes së vendimit, komisioni i vlerësimit është dashur të marrë në konsideratë edhe praktikën e vendimeve të mëparshme të Organit Shqyrtues të Prokurimit, përkatësisht vendimet e Panelit Shqyrtues me nr. PSH 1034/23, datë 07.02.2024, PSH 2024/0431, datë

03.07.2024, PSH 2024/0674, datë 25.09.2024, në të cilat janë trajtuar dhe vlerësuar çështjet që lidhen me ofertat me çmime jo-normalisht të ulëta në pozicione të ndryshme të shërbimeve të projektimit dhe shërbimeve profesionale.

Në përputhje me **nenin 41.6 të Rregullores Nr. 001/2022** për Prokurimin Publik, si dhe duke u mbështetur në praktikën e lartcekur të Panelit Shqyrtues, ju si Autoritet Kontraktues është dashur që ofertën e Grupit të Operatorëve Ekonomikë të rekomanduar për kontratë të konsiderohej si **Ofertë e Papërgjegjshme**.

PRETENDIMI ANKIMOR NR.2

Mospërmbushja e kërkesave të Kërkesës nr. 6 – Dron profesional me kamerë oblik dhe rezolucion minimal 60 MP

Grup i Operatorëve Ekonomikë (GOE) I rekomanduar për kontratë nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, përkatësisht kërkesat që lidhen me kapacitetin teknik dhe profesional tek kërkesa e paisjeve.

Konkretisht, në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, në kuadër të **Kapacitetit Teknik dhe Profesional për paisjen**:

Kërkesa 6 Një (1) DRON profesional i dedikuar për inspektim, monitorim apo rilevim gjeodezik, i paisur me kamerë oblik, me rezolucion jo më pak se 60 megapixel. Droni duhet të ketë mundësinë e matjes me PPK (post processing kinematic) dhe softuerin e procesimit PPK. Duhet të prezantohet aprovimimi nga ACC për inxhinierin për operimin e dronit të prezantuar. Për inxhinierin të paraqitet çertifikata e lëshuar nga ACC për operim të dronit

është kërkuar si dëshmi dokumentare”

Dëshmia 6 . Për paisjen të prezantohet dokumenti i pronësis (DUD doganor apo fature blerje) ose marreveshje për qira e nënshkruar tek noteri.. Për inxhinierin të paraqitet çertifikata e lëshuar nga ACC për operim të dronit dhe duhet të prezantohet aprovimimi nga ACC për inxhinierin për operimin e dronit të prezantuar. Të prezantohet specifikacioni nga prodhuesi i Dronit, për dronin dhe kamerën.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, ne kemi konstatuar se grupi I operatoreve ekonomik sa I perket kërkesës 6 ka prezantuar dy paisje(dron)pajisjet:

- DJI Mavic 3 Enterprise dhe
- DJI Matrice 400 me sensor Zenmuse L3.

Gjatë analizës së dokumentacionit teknik të dorëzuar është konstatuar se:

DJI Mavic 3 Enterprise është i pajisur me kamerë standard(40megapixel) me kënd vertikal (nadir) për fotografim dhe inspektim ajror. Kjo kamerë nuk paraqitet nga prodhuesi si kamerë oblik dhe nuk përbën sistem të fotografimit oblik të dedikuar për fotogrametri profesionale.

Ndërsa **DJI Matrice 400 me Zenmuse L3** paraqet një platformë profesionale të pajisur kryesisht me sensor LiDAR për skanimit laserik dhe me kamera ndihmëse për dokumentim vizual. Zenmuse L3 nuk paraqitet nga prodhuesi si kamerë oblik dhe nuk përbën sistem fotografik oblik me shumë kënde fotografimi, siç kërkohet në Dosjen e Tenderit.

Edhe pse pajisja e prezantuar DJI Matrice 400 me Zenmuse L3 posedon kamerë me rezolucion mbi minimumin e kërkuar prej 60 MP, GOE të rekomanduar për kontratë nuk ka dëshmuar se kamera e prezantuar është kamerë oblik (oblique camera), siç kërkohet shprehimisht në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë. Për rrjedhojë, nuk është dëshmuar përmbushja e plotë e kërkesës teknike nr. 6, pasi kushtet "kamerë oblik" dhe "rezolucion jo më pak se 60 MP" janë kërkesa minimale dhe duhet të përmbushen njëkohësisht.

Ne fillimisht ju sqarojmë se **kamera oblik (Oblique Camera)** është një sistem kamerash i projektuar posaçërisht për fotogrametri profesionale dhe rievime gjeodezike. Ndryshe nga kamerat standarde që fotografojnë vetëm vertikalisht (nadir), kamerat oblik realizojnë fotografime nga kënde të ndryshme (përpara, prapa, majtas, djathtas dhe vertikalisht), duke mundësuar krijimin e modeleve 3D me saktësi të lartë, dokumentimin e fasadave të objekteve, analizën e terrenit dhe prodhimin e ortofotove dhe modeleve tridimensionale profesionale.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar në mënyrë specifike që droni të jetë i pajisur me **kamerë oblik**, e jo thjesht me kamerë standarde fotografike ose sensor për skanim.

Ne vlerësojmë se ekziston dallim i qartë teknik ndërmjet kamerave standarde ose sensorëve LiDAR të prezantuar nga GOE të rekomanduar për kontratë dhe kamerave oblik të dedikuara për fotogrametri profesionale.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga GOE nuk është dëshmuar se DJI Mavic 3 Enterprise apo DJI Matrice 400 me Zenmuse L3 posedojnë kamerë oblik, siç kërkohet shprehimisht në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë. Për rrjedhojë, GOE nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e një kërkesë minimale dhe obligative teknike të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Meqenëse kërkesa për kamerë oblik është kërkesë e qartë, e matshme dhe e detyrueshme e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë, mungesa e dëshmisë për përmbushjen e saj e bën ofertën teknikisht të papërgjegjshme.

Prandaj, bazuar në nenin 59.4 të Ligjit për Prokurimin Publik, sipas të cilit Autoriteti Kontraktues mund të konsiderojë një ofertë si të përgjegjshme vetëm nëse ajo përmbush të gjitha kërkesat, kushtet dhe specifikimet e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, autoriteti kontraktues është dashur që GOE të rekomanduar për kontratë ta shpall të papërgjegjshëm pasi që nuk ka dëshmuar përmbushjen e Kërkesës nr. 6.

PRETENDIMI ANKIMOR NR.3

Grupi i Operatorëve Ekonomikë (GOE) I rekomanduar për kontratë nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, përkatësisht kërkesat që lidhen me kapacitetin teknik dhe profesional tek kërkesa e paisjeve.

Konkretisht, në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, në kuadër të **Kapacitetit Teknik dhe Profesional për paisjen:**

Kërkesa 7 Një (1) PAISJE GJEODEZIKE GPS GNSS RTK-Advanced Engine System me minimum 1408 kanale satelitore, me dual kamerë në kokë-resiver, controller Handy me kamerë në kontrollor- terminal, me opsion rievimi 3D me fotografi (fotogrametri) dhe me

laser, mundesine e modelimit 3D dhe piketimi real view me kamerë

është kërkuar si dëshmi dokumentare

Dëshmia 7 . Për paisjen të prezantohet dokumenti i pronësis (DUD doganor apo fature blerje) ose marreveshje për qira e nënshkruar tek noteri. Të prezantohet specifikacioni nga prodhuesi i paisjes.

Grupi I operatoreve ekonomik(GOE) nuk ka paraqitur pajisjes sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë , por ka paraqitur Nje (1) paisje **hi-target V600L**, e cila paisje nuk ploteson kushtin minimal **“me opsion rilevimi 3D me fotografi (fotogrametri) dhe me mundësinë e modelimit 3D”**, dhe GOE ka prezantuar Nje (1) pajisje tjetër me emrin **Hi-Target vRTK** nuk ploteson kushtin minimal **“mundesin e matjes me Laser”**, në kërkesa është kërkuar një pajisje me dy opsionet. Po ashtu GOE nuk ka prezantur specifikacionin e pajisjes nga prodhuesi me emrin **Hi-Target vRTK**.

GOE nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e plotë të Kërkesës nr. 7, e cila kërkon një pajisje GNSS RTK me opsion rilevimi 3D me fotografi (fotogrametri), matje me laser, modelim 3D dhe Real View Stakeout me kamerë. Dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmon posedimin e të gjitha këtyre karakteristikave teknike, ndërsa për pajisjen Hi-Target vRTK mungon edhe specifikacioni teknik i prodhuesit, duke e bërë të pamundur verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Prandaj, duke u bazuar në **nenin 59.4 të Ligjit për Prokurimin Publik**, autoriteti kontraktues është dashur që ofertën e Grupit të Operatorëve Ekonomikë ta konsiderojë si **Ofertë të Papërgjegjshme**.

PËRFUNDIM:

Përfundimisht autoriteti kontraktues ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së, nenit 61 të LPP-së, nenit **41.6 të Rregullores Nr. 001/2022** për Prokurimin Publik, vendimet e mëparshme të panelit shqyrtues: **PSH 1034/23, datë 07.02.2024, PSH 2024/0431, datë 03.07.2024, PSH 2024/0674, datë 25.09.2024**, ndërsa nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP –së kriteri kryesor për dhënjen e kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me poentim.

Ju sqarojmë se autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Duke vepruar në këtë mënyrë, AK-ja njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së sepse na ka diskriminuar neve edhe pse i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe është dashur të shpallemi operator ekonomik i rekomanduar për kontratë.

Duke u bazuar në faktet që u përmendën më lartë autoriteti kontraktues me këto veprime ka rënë në kundërshtim me nenin 1 të LPP-së sepse aty shkruan qartë: ***Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve***

publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Në fund kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të nxjerrni:

Në këtë rast nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së, dhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët me poentim. Ndërsa ju sqarojmë edhe një herë se në këtë aktivitet të prokurimit, jemi ne që i plotësojmë të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë dhe gjithashtu jemi ofertues me çmimin më të lirë të përgjegjshëm.

Vendimet e OSHP-së janë të obligueshme për tu zbatuar nga ana e autoriteteve kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët kanë të drejtë ti drejtohen gjykatës kompetente brenda afateve ligjore me anë të mjeteve të rregullta juridike konform këshillës juridike të dhënë në vendim.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e OE **"PROing&Partners"SH.P.K** si e bazuar

ANULOHET njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**.

DETYROHET autoriteti kontraktues të bëjë rivlerësimin e ofertave sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë sepse ne si kompani i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe duhet të shpallemi fitues të këtij tenderi.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Vlera e dëmit kap shumën 80,000.00 Euro të cilën Autoriteti Kontraktues është i obliguar ta paguaj në rast se humb kontekstin Gjyqësor.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit".
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.
- e) Vendimet e panelit shqtrtues: me nr. PSH 1034/23, datë 07.02.2024, PSH 2024/0431, datë 03.07.2024, PSH 2024/0674, datë 25.09.2024

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO
KUVENDI I KOMUNES - SKUPŠTINA OPŠTINE
DRAGASH - DRAGAŠ
ZYRA PËR PROKURIM – KANCELARIJA ZA JAVNU NABAVKU

Zyra për prokurim në Dragash, në bazë të kërkesës për rishqyrtim të bërë me datë 03.08.2026 nga Operatori Ekonomik "PROing&Partners Sh.p.k-Prishtinë", në lidhje me aktivitetin e Prokurimit 021 "Hartimi i projekteve për nevojat e Komunes së Dragashit (24 muaj)" me numër identifikues: 621-26-4068-2-2-1, dhe nr. të mbrendshëm 621-2026-021-221., dhe duke u bazuar në Rregulloren Nr/001-2022 (të konsoliduar) nenin 63.1.1 nën a), të kësaj rregulloreje-të aprovuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik i cili në pajtim me Nenin 87.2.4, të Ligjit mbi prokurimin Publik nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.04/L-237, ligjin nr.05/L-068 dhe ligjin nr.05/L-092, bjen kete :

V E N D I M

1. REFUZOHET si e pa bazuar për Rishqyrtim kërkesa e OE "PROing&Partners Sh.p.k-Prishtinë
2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 28.07.2026.

ARSYETIM

Lidhur me kerkesen tuaj per rishqyrtim te dates 03.08.2026 te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues te dates 28.07.2026 ne lidhje me aktivitetin e prokurimit me nr, te prokurimit 021 " Hartimi i projekteve per nevojat e Komunes se Dragashit(24 muaj)" me numër identifikues: 621-26-4068-2-2-1, dhe nr, te mbrendshem 621-2026-021-221, konstatojme se kerkesa juaj e parashtruar per Rishqyrtim eshte e pa bazuar.

AK, gjegjesisht Komisioni per vlersim kane konstatuar se OE te cilin AK e ka shpallur si te pergjegjeshem I ploteson kriteret e kerkuara sipas njoftimit per kontrate.

Pretendimi Ankimor nje: se OE I shperblyer me kontrate ka ofertuar me çmime jo-normalisht te uleta sipas paramases dhe parallogarise ne shumicen e pozicioneve bazuar ne **Letren standarde te kerkeses per informata mbi tenderet jo-normalisht te ulet(B 41)** te kerkuar me date 07.07.2026 nga AK, komisioni per vlersim e **ka pranuar arsyetimin e OE**, se me çmime te njejta AK e ka shperblyer te njejtin OE me kontrate ne vitet paraprake(ka ofruar deshmi raportet e pranimit te menagjerit te projektit dhe te komisioneve te pranimit teknik).


Prandaj per AK **vlersojme se ky pretendim I juaji nuk qendron.**

Pretendimi ankimor I dyte: se OE I shperblyer me kontrate nuk ploteson kerketat sipas dosjes se tenderit dhe Njoftimit per kontrate perkatesisht **Kapacitetin teknik dhe profesional** per paisjen nje **DRON** profesional I dedikuar per inspektim,monitorim apo rilevim gjeodezik, I paisur me kamere oblik,me relozucion jo me pak se 60 megapixel.

Duhet te prezantohet aprovimi nga ACC per inxhinierin per operim te dronit te prezantuar.Per inxhinierin te paraqitet çertifikata e leshuar nga ACC per operim te dronit.

Lidhur me kete ju sqarojme se AK bazuar ne te drejten e saj per informacione shtes nga OE konkurues per paisjet e kerkuara(per Kapacitetin tekniko-profesional), te bere me date 07.07.2026 ka pranuar sqarimet qe jane te mjaftueshme se I ploteson kriteret e kerkuara sipas Njoftimit per kontrate, dhe se Inxhinieret Gezim Sylaj dhe Besart Halimi jane te paisur me çertifikata te leshuara nga CAA-shih ne vazhdim,prandaj vlersojme se edhe ky **pretendim nuk qendron.**

Çertifikatë nga Autoriteti i Aviacionit Civil për kalimin e testit të njohurive për përdorimin e Dronit pa p

 Republika e Kosovës Republic of Kosovo	 Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo	Numri i Çertifikatës: Ky Çertifikatë: Certificate Number CAA UAS CER 29 Numri i dosjes: Dosja Dosje: File Number GAT-2025-UAS
--	---	--

CERTIFIKATË SERTIFIKAT – CERTIFICATE

*Kjo Çertifikatë i lëshohet
Ovaj Sertifikat izdaje se - This certificate is issued to*

Gëzim Sylaj

Rr. Prishtinë Republika e Kosovës

*I cili ka kaluar me sukses testin e njohurive sipas Rregulorës (AAC) nr. 01/2017
për Sistemet e Mjetëve Ajrore pa pilot (SAP), siç është ndryshuar
kaj je uspešno položio test znanja prema Uredbe (ACV) br. 01/2017
o Sistemima Bezpilotnih Letelica (SBL), sa izmenama
who has successfully passed the knowledge test in accordance with Regulation (CAA) no. 01/2017
on Unmanned Aircraft Systems (UAS), as amended*


*Kjo Çertifikatë lëshohet për një periudhë të pacaktuar
Ovaj Sertifikat izdaje se na neodređeno vreme
This Certificate is issued for an indefinite period*

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

08.12.2025




Matëj Krasniqi


Ud Dregjor i Përgjithshëm
Generali Direktor - Director General

Lëshuar në përputhje me nenin 12.7 të Rregulorës (AAC) nr. 01/2017, siç është ndryshuar.
Izdato u skladu sa Članom 12.7 Uredbe (ACV) br. 01/2017, sa izmenama.
Issued in accordance with article 12.7 of Regulation (CAA) No. 01/2017, as amended.

Çertifikatë nga Autoriteti i Aviacionit Civil për kalimin e testit të njohurive për përdorimin e Dror

 Republika e Kosovës Republic of Kosovo	 Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civiling Vazhdplovostris Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo	Numri i Certifikatës: Bijj Serifikula Certificate Number: Numri i dosjes: Bijj Dosjes File Number: CAA UAS CER.13 GAT-2024-UAS
--	---	---

CERTIFIKATË SERTIFIKAT- CERTIFICATE

Kjo Certifikatë i lëshohet
Ovaj Sertifikat izdaje se - This certificate is issued to

Besart Halimi
Rr. Ndue Perllashi Mati 1 Banesat e Pozhegut B2 1/6

r o l i k a k a l u a r m e s u k s e s t e s t i n e n j o h u r i v e s i p a s R r e g u l o r e s (A A C) b r . 0 1 / 2 0 1 7
p e r S i s t e m e t e M j e t e v e A j r o r e p a p i l o t (S A P) , s i q e s h t e n d r y s h u a r
k o j n u s p e s h n o p o l o z h i i o A j r o r e p a p i l o t (S A P) , s i q e s h t e n d r y s h u a r
k o j j e u s p e s h n o p o l o z h i l e s t z n a n j a p r e m a U r e d b e (A C V) b r . 0 1 / 2 0 1 7 ,
o S i s t e m i m a B e z p i l o t n i h L e t e l i c a (S B L) , s a a m e r i a m a
w h o h a s s u c c e s s f u l l y p a s s e d t h e k n o w l e d g e t e s t i n a c c o r d a n c e w i t h R e g u l a t i o n (C A A) n o . 0 1 / 2 0 1 7
o n U n m a n n e d A i r c r a f t S y s t e m s (U A S) , a s a m e n d e d


Kjo Certifikatë lëshohet për një periudhë të pacaktuar
Ovaj Sertifikat izdaje se na neodredeno vreme
This Certificate is issued for an indefinite period

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

06.02.2024



Burim Dinarama



Ud.Drejtor i Përgjithshëm
Generalni Direktor - Director General

Lëshuar në përputhje me nenin 12.7 të Rregulorës (AAC) Nr. 01/2017, siq është ndryshuar
Izdato u skladu sa Canon 12.7 Uredbe (ACV) Br. 01/2017, sa izmenjena
Issued in accordance with article 12.7 of Regulation (CAA) No. 01/2017, as amended

Pretendimi ankimor I trete se:

Grupi I OE te shperblyer me kontrate nuk ka ofruar paisjet sipas Njoftimit per Kontrate, Konkretisht NJE PAISJE GJEODEZIKE GPS GNSS RTK-Advanced Engine system. **Edhe ky pretendim nuk qendron** pasi qe paisja e ofruara ploteson kushtin minimal sipas dosjes se tenderit.

Prandaj ne fund vendoset si ne dispozitiv te ketij vendimi.

Keshilla juridike: Pala e pa kenaqur sipas nenit 109 te ketij Ligji, mund te ankohet ne Organin Shyrtues te Prokurimit Publik te Kosoves ne afat prej 10 ditesh, nga marrja e ketij vendimi

Dragash 05.08.2026

U.D- zyrtari pergjegjes per prokurim

Fadil Sinani



KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	621-26-4068-2-2-1
------------------	-------------------

Sa i përket tenderit për: **021- Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës së Dragashit – 24 Muaj**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

“PROing&Partners”SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

K.Dielli, Major M. Bushi Lam. 12/11 Z. e Perëndimit

(Adresa)

Prishtinë

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

048 313 525

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Vadet Zena

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

proing2005@gmail.com

(Adresa elektronike)

03.08.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 29.05.2026

Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 29.06.2026

Kriteri për dhënie ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me poentim

Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 29.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo



Jemi njoftuar përmes sistemi elektronik e-prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtejshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 1 Qëllimi
- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët
- Neni 64 Dëshmitë e kërkesave
- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Nenin 41.6 të Rregullores Nr. 001/2022
- Vendimet e panelit shqyrtues: me nr. PSH 1034/23, datë 07.02.2024, PSH 2024/0431, datë 03.07.2024, PSH 2024/0674, datë 25.09.2024

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Të nderuar ne me datë **29.07.2026** përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar nga AK me *Letër standarte mbi tenderuesin e Pasukëseshëm*, ndërkaq është rekomanduar për kontratë Grupi i operatoreve ekonomik: **STUDIO HAPSIRA SHPK & SEMAKS SHPK & DEA GROUP SHPK & GEOPLAN & CONSULTING GROUP SHPK**

Ju sqarojmë se ne me dt. 30.07.2026 kemi pasur qasje në dokumente zyrtare për grupin e operatoreve Ekonomik(GOE) të rekomanduar për kontratë në këtë procedure tenderuese.

PRETENDIMI ANKIMOR 1

Në pajtim me nenin 61, paragrafin 4, të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, vlera e ofruar nga GOE është jo-normalisht e ulët. Në pajtim me Nenin 3, konkretisht pika 3.2 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, nenin 41 konkretisht neni 41.6 të Rregullores NR.001/2022 Për Prokurim Publik dhe nenin 61 konkretisht 61.4 ligjit të LPP-së.

Pas analizimit dhe shqyrtimit të Ofertës Financiare të dorëzuar nga GOE të rekomanduar për kontratë, ne mendojmë se në ofertën e dorëzuar në shumicën e pozicioneve GOE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime jo-normalisht të ulëta, konkretisht si më poshtë:

- Pozicioni **I.A.1** ka vendosur çmimin 0.03€/m²
- Pozicioni **I.A.2** ka vendosur çmimin 0.03€/m²
- Pozicioni **I.A.3** ka vendosur çmimin 0.03€/m²
- Pozicioni **I.A.4** ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni **I.A.5** ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni **I.A.6** ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni **I.A.7** ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni **I.A.8** ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni **I.A.9** ka vendosur çmimin 0.05€/m²
- Pozicioni **I.B.2** ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni **I.B.3** ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni **I.B.4** ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni **I.B.5** ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni **I.B.6** ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni **I.B.7** ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni **I.C.2** ka vendosur çmimin 0.01€/m
- Pozicioni **I.C.3** ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni **I.C.5** ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni **I.C.6** ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni **I.C.7** ka vendosur çmimin 0.01€/m
- Pozicioni **I.C.8** ka vendosur çmimin 0.01€/m
- Pozicioni **I.C.9** ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni **I.C.11** ka vendosur çmimin 0.01€/m
- Pozicioni **I.D.1** ka vendosur çmimin 0.10€/m
- Pozicioni **I.D.2** ka vendosur çmimin 0.10€/m
- Pozicioni **I.D.3** ka vendosur çmimin 0.01€/m

- Pozicioni I.D.4 ka vendosur çmimin 0.01€/m³
- Pozicioni I.D.5 ka vendosur çmimin 0.01€/m
- Pozicioni I.D.6 ka vendosur çmimin 0.01€/m³
- Pozicioni I.D.7 ka vendosur çmimin 0.01€/m
- Pozicioni I.D.8 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.D.9 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.E.1 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.E.2 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.E.3 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.E.4 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.E.5 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.E.6 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.E.7 ka vendosur çmimin 0.01€/m²
- Pozicioni I.E.8 ka vendosur çmimin 0.01€/m²

Pas qasjes në dokumente kemi parë që ju si AK i keni kërkuar sqarime shtesë për pozicionet e lartëcekura, për të cilat komisioni ka kërkuar nga Zyrtari i Prokurimit që në harmoni me **nenin 3.2 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët** dhe duke u bazuar në **nenin 41.6 të Rregullores NR.001/2022** të kërkojë sqarim shtesë të GOE të rekomanduar për kontratë rreth çmimeve të ofruara.

Brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues, Grupi Operatoreve Ekonomikë (GOE) i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar sqarimet dhe arsyetimet e kërkuara lidhur me çmimet e ofertuara. Në sqarimet e GOE të rekomanduar për kontratë thuhet se ka realizuar kontrata të ngjashme në të kaluarën me autoritetin kontraktues dhe në bazë të këtyre sqarime autoriteti kontraktues ka vlerësuar se oferta nuk është jonormalisht e ulët dhe e ka rekomanduar për kontratës. Komisioni i Vlerësimit ka shqyrtuar të gjitha sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur, dhe i ka merrë për bazë sqarimet e GOE dhe e ka rekomanduar për kontratë

Ne mendojmë se arsyetimet e dhëna nga Grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë me arsyetimet se ka realizuar kontrata të ngjashme në të kaluarën, përfshirë kontrata me Autoritetin Kontraktues, nuk është vendimtar për vlerësimin e kësaj procedure të prokurimit. Çdo procedurë zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe vlerësimi bëhet mbi bazën e dokumentacionit dhe ofertës së paraqitur në procedurën konkrete. Përvoja e mëparshme nuk përbën në vetvete provë se çmimet e ofertuara në këtë procedurë janë të realizueshme. Çdo procedurë e prokurimit ka karakteristikat e veta specifike, ndërsa Komisioni i Vlerësimit është i obliguar të vlerësojë secilën ofertë mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar, kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe dispozitave të zbatueshme ligjore.

Nga analiza e këtyre pozicioneve rezulton se çmimet e ofertuara janë në nivele simbolike dhe nuk pasqyrojnë koston reale të angazhimit të stafit profesional, analizave teknike, projektimit, koordinimit, kontrollit të cilësisë dhe përgjegjësisve profesionale që kërkohen për realizimin e këtyre shërbimeve.

Në rastin konkret, sqarimet e paraqitura nuk arrijnë të dëshmojnë se si shërbime profesionale të kësaj natyre mund të realizohen me çmime prej 0.01 €, 0.02 €, 0.04 € apo 0.05 €, pa cenuar realizueshmërinë e kontratës.

Pas shqyrtimit të ofertës, përshkrimit të çmimeve, analizës së tregut dhe sqarimeve të dorëzuara nga GOE të rekomanduar për kontratë Autoriteti Kontraktues është dashur ta eliminojë këtë GOE pasi që ekzistojnë prova dhe indikacione të mjaftueshme që oferta përmban çmime jo-normalisht të ulëta në

një numër të konsiderueshëm pozicionesh, të evidentuara në analizën e çmimeve dhe në kërkesën për sqarime.

Ne mendojmë se, pas shqyrtimit të argumenteve të paraqitura në përshkrimin e çmimeve, ka prova të mjaftueshme që oferta e GOE të rekomanduar për kontratë është ofertë me çmime jo-normalisht të ulëta. Në harmoni me Ligjin për Prokurim Publik të Kosovës, veçanërisht në bazë të **nenit 41.6** të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022, dhe vendimeve të mëparshme të Panelit Shqyrtues, autoriteti kontraktues është dashur të konstatoi se oferta në fjalë e GOE të rekomanduar për kontratë është ofertë me çmime jo-normale të ulëta në shumë pozicione të cilat janë evidentuar në Përshkrim të Çmimeve.

Gjatë marrjes së vendimit, komisioni i vlerësimit është dashur të marrë në konsideratë edhe praktikën e vendimeve të mëparshme të Organit Shqyrtues të Prokurimit, përkatësisht vendimet e Panelit Shqyrtues me nr. PSH 1034/23, datë 07.02.2024, PSH 2024/0431, datë 03.07.2024, PSH 2024/0674, datë 25.09.2024, në të cilat janë trajtuar dhe vlerësuar çështjet që lidhen me ofertat me çmime jo-normalisht të ulëta në pozicione të ndryshme të shërbimeve të projektimit dhe shërbimeve profesionale.

Në përputhje me **nenin 41.6** të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe duke u mbështetur në praktikën e lartcekur të Panelit Shqyrtues, ju si Autoritet Kontraktues është dashur që ofertën e Grupit të Operatorëve Ekonomikë të rekomanduar për kontratë të konsiderohej si **Ofertë e Papërgjegjshme**.

PRETENDIMI ANKIMOR 2

Grup i Operatorëve Ekonomikë (GOE) I rekomanduar për kontratë nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, përkatësisht kërkesat që lidhen me kapacitetin teknik dhe profesional tek kërkesa e paisjeve.

Konkretisht, në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, në kuadër të **Kapacitetit Teknik dhe Profesional** për paisjen:

Kërkesa 6 Një (1) DRON profesional i dedikuar për inspektim, monitorim apo rilevim gjeodezik, i paisur me kamerë oblik, me rezolucion jo më pak se 60 megapixel. Droni duhet të ketë mundësinë e matjes me PPK (post processing kinematic) dhe softuerin e procesimit PPK. Duhet të prezantohet aprovimi nga ACC për inxhinierin për operimin e dronit të prezantuar. Për inxhinierin të paraqitet certifikata e lëshuar nga ACC për operim të dronit

është kërkuar si dëshmi dokumentare”

Dëshmia 6 . Për paisjen të prezantohet dokumenti i pronësis (DUD doganor apo fature blerje) ose marreveshje për qira e nënshkruar tek noteri.. Për inxhinierin të paraqitet certifikata e lëshuar nga ACC për operim të dronit dhe duhet të prezantohet aprovimi nga ACC për inxhinierin për operimin e dronit të prezantuar. Të prezantohet specifikacioni nga prodhuesi i Dronit, për dronin dhe kamerën.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, ne kemi konstatuar se grupi I operatoreve ekonomik sa I perket kërkesës 6 ka prezantuar dy paisje(dron)pajisjet:

- DJI Mavic 3 Enterprise dhe
- DJI Matrice 400 me sensor Zenmuse L3.

Gjatë analizës së dokumentacionit teknik të dorëzuar është konstatuar se:

DJI Mavic 3 Enterprise është i pajisur me kamerë standard (40 megapixel) me kënd vertikal (nadir) për fotografim dhe inspektim ajror. Kjo kamerë nuk paraqitet nga prodhuesi si kamerë oblik dhe nuk përbën sistem të fotografimit oblik të dedikuar për fotogrametri profesionale.

Ndërsa **DJI Matrice 400 me Zenmuse L3** paraqet një platformë profesionale të pajisur kryesisht me sensor LiDAR për skanim laserik dhe me kamera ndihmëse për dokumentim vizual. Zenmuse L3 nuk paraqitet nga prodhuesi si kamerë oblik dhe nuk përbën sistem fotografik oblik me shumë kënde fotografimi, siç kërkohet në Dosjen e Tenderit.

Edhe pse pajisja e prezantuar DJI Matrice 400 me Zenmuse L3 posedon kamerë me rezolucion mbi minimumin e kërkuar prej 60 MP, GOE të rekomanduar për kontratë nuk ka dëshmuar se kamera e prezantuar është kamerë oblik (oblique camera), siç kërkohet shprehimisht në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë. Për rrjedhojë, nuk është dëshmuar përmbushja e plotë e kërkesës teknike nr. 6, pasi kushtet "kamerë oblik" dhe "rezolucion jo më pak se 60 MP" janë kërkesa minimale dhe duhet të përmbushen njëkohësisht.

Ne fillimisht ju sqarojmë se **kamera oblik (Oblique Camera)** është një sistem kamerash i projektuar posaçërisht për fotogrametri profesionale dhe rëlevime gjeodezike. Ndryshe nga kamerat standarde që fotografojnë vetëm vertikalisht (nadir), kamerat oblik realizojnë fotografime nga kënde të ndryshme (përpara, prapa, majtas, djathtas dhe vertikalisht), duke mundur krijimin e modeleve 3D me saktësi të lartë, dokumentimin e fasadave të objekteve, analizën e terrenit dhe prodhimin e ortofotove dhe modeleve tridimensionale profesionale.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar në mënyrë specifike që droni të jetë i pajisur me **kamerë oblik**, e jo thjesht me kamerë standarde fotografike ose sensor për skanim.

Ne vlerësojmë se ekziston dallim i qartë teknik ndërmjet kamerave standarde ose sensorëve LiDAR të prezantuar nga GOE të rekomanduar për kontratë dhe kamerave oblik të dedikuara për fotogrametri profesionale.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga GOE nuk është dëshmuar se DJI Mavic 3 Enterprise apo DJI Matrice 400 me Zenmuse L3 posedojnë kamerë oblik, siç kërkohet shprehimisht në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë. Për rrjedhojë, GOE nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e një kërkesë minimale dhe obligative teknike të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Meqenëse kërkesa për kamerë oblik është kërkesë e qartë, e matshme dhe e detyrueshme e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë, mungesa e dëshmisë për përmbushjen e saj e bën ofertën teknikisht të papërgjegjshme.

Prandaj, bazuar në nenin 59.4 të Ligjit për Prokurimin Publik, sipas të cilit Autoriteti Kontraktues mund të konsiderojë një ofertë si të përgjegjshme vetëm nëse ajo përmbush të gjitha kërkesat, kushtet dhe specifikimet e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, autoriteti kontraktues është dashur që GOE të rekomanduar për kontratë ta shapll të papërgjegjshëm pasi që nuk ka dëshmuar përmbushjen e Kërkesës nr. 6.

PRETENDIMI ANKIMOR 3

Grupi i Operatorëve Ekonomikë (GOE) I rekomanduar për kontratë nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, përkatësisht kërkesat që lidhen me kapacitetin teknik dhe profesional tek kërkesa e paisjeve.

Konkretisht, në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, në kuadër të **Kapacitetit Teknik dhe Profesional për paisjen:**

Kërkesa 7 Një (1) PAISJE GJEODEZIKE GPS GNSS RTK-Advanced Engine System me minimum 1408 kanale satelitore, me dual kamerë në kokë-resiver, controller Handy me kamerë në kontroll-terminal, me opsion rilevimi 3D me fotografi (fotogrametri) dhe me laser, mundësinë e modelimit 3D dhe piketimi real view me kamerë

është kërkuar si dëshmi dokumentare

Dëshmia 7 . Për paisjen të prezantohet dokumenti i pronësis (DUD doganor apo fature blerje) ose marreveshje për qira e nënshkruar tek noteri. Të prezantohet specifikacioni nga prodhuesi i paisjes.

Grupi i operatoreve ekonomik(GOE) nuk ka paraqitur pajisjes sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë , por ka paraqitur Nje (1) paisje **hi-target V600L**, e cila paisje nuk ploteson kushtin minimal **“me opsion rilevimi 3D me fotografi (fotogrametri) dhe me mundësinë e modelimit 3D”**, dhe GOE ka prezantuar Nje (1) pajisje tjetër me emrin **Hi-Target vRTK** nuk ploteson kushtin minimal **“mundësin e matjes me Laser”**, në kërkesa është kërkuar një pajisje me dy opsionet. Po ashtu GOE nuk ka prezantur specifikacionin e pajisjes nga prodhuesi me emrin Hi-Target vRTK.

GOE nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e plotë të Kërkesës nr. 7, e cila kërkon një pajisje GNSS RTK me opsion rilevimi 3D me fotografi (fotogrametri), matje me laser, modelim 3D dhe Real View Stakeout me kamerë. Dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmon posedimin e të gjitha këtyre karakteristikave teknike, ndërsa për pajisjen Hi-Target vRTK mungon edhe specifikacioni teknik i prodhuesit, duke e bërë të pamundur verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Prandaj, duke u bazuar në **nenin 59.4 të Ligjit për Prokurimin Publik**, autoriteti kontraktues është dashur që ofertën e Grupit të Operatorëve Ekonomikë ta konsiderojë si **Ofertë të Papërgjegjshme**.

PËRFUNDIM:

Përfundimisht ju si autoritet kontraktues ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e keni bërë konform nenit 59 të LPP-së, nenit 61 të LPP-së, nenit 41.6 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, vendimet e mëparshme të panelit shqyrtues: PSH 1034/23, datë 07.02.2024, PSH 2024/0431, datë 03.07.2024, PSH 2024/0674, datë 25.09.2024, ndërsa nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP –së kriteri kryesor për dhënjën e kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me poentim.

Ju sqarojmë se autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Duke vepruar në këtë mënyrë, AK-ja njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së sepse na ka diskriminuar neve edhe pse i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe është dashur të shpallemi operator ekonomik i rekomanduar për kontratë.

Duke u bazuar në faktet që u përmendën më lartë autoriteti kontraktues me këto veprime ka rënë në kundërshtim me nenin 1 të LPP-së sepse aty shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.*

Në fund kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të nxjerrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE “**PROing&Partners**” SH.P.K.

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënjë të kontratës dhe lënda të kthehet në **RISHQYRTIM** dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Vlera e dëmit kap shumën 80,000.00 Euro të cilën Autoriteti Kontraktues është i obliguar ta paguaj në rast se humb kontekstin Gjyqësor.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) Një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit".
- b) Një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) Një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) Një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet





B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: 021-Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës së Dragashit-24 Muaj

Nr. i prokurimit ²	621-26-4068-2-2-1
Nr i brendshëm	621-26-021-2-2-1

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave ³
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik STUDIO HAPSIRA SH.P.K.; SEMAKS SH.P.K.; DEA GROUP SH.P.K.; GEOPLAN&CONSULTING GROUP SH.P.K.,	0.86
2	ENG IDEA SH.P.K., Brigada 123, 23000, Suhareke,	18.38
3	Grup i Operatorëve Ekonomik PROing&Partners SH.P.K.; GEOCAD Group SH.P.K.,	41.55
4		
5		

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Kuvendi Komunal-Dragash shpërblen me kontratë sipas qmimit të poentuar:

Grup i Operatorëve Ekonomik STUDIO HAPSIRA SH.P.K.; SEMAKS SH.P.K.; DEA GROUP SH.P.K.; GEOPLAN&CONSULTING GROUP SH.P.K me qmimin njësi të poentuar 0.86 euro

Data: 28.07.2026

Emri dhe mbiemri i ZPP:U.D-Fadil Sinani

¹ Ketij formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde të njoftimeve: B42, B45 dhe B46.(shtoni letra njoftuese sipas nevojës).

² Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

³ Në rast të procedurave të kufizuara/procedurave konkurruese me negociata t'i bashkangjiten letrat standarde të njoftimeve: B43 dhe B44.(shto letra standarde sipas nevojës), derisa kolona "Vlera totale e ofertave" nuk plotsohet me të dhëna.

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

B42 - Letër standarde për [tenderuesin] [kandidatin] e eliminuar ⁴

Datë: 28.07.2026

Kuvendi Komunal-Dragash

ENG IDEA SH.P.K., Brigada 123, 23000, Suhareke,

Nr. i prokurimit ⁵	621-26-4068-2-2-1
Nr i brendshëm	621-26-021-2-2-1

Titulli: 021-Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës së Dragashit-24 Muaj

I/e nderuar(a) [Z/Znj]]

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP [Tenderi juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në [dosjen e tenderit] [dokumentet parakualifikuese]. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim: [Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM

[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

[Deklaroni arsyet e hollësishme mbi refuzimin në përputhje me rrethanat]

Letër standarde për sqarim e dërguar me datë 07.07.2026.

Nuk keni ofruar përgjegje ndaj letrës standarde për sqarim brenda afatit ligjor .

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.


Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Fadil Sinani

Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit

U-D


(Nënshkrimi)

⁴ Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojës).

⁵ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

B45 - Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm¹²

Datë: 28.07.2026

Kuvendi Komunal-Dragash

STUDIO HAPSIRA SH.P.K.; SEMAKS SH.P.K.; DEA GROUP SH.P.K.;
GEOPLAN&CONSULTING GROUP SH.P.K

Nr. i prokurimit ¹³	621-26-4068-2-2-1
Nr i brendshëm	621-26-021-2-2-1

Titulli: 021-Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës së Dragashit-24 Muaj

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar *[tenderin me çmimin më të ulët]* si përgjigje ndaj për aktivitetin e prokurimit të lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj *[OPCIONI: pas korrigjimit të gabimeve aritmetikore]* dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Grup i Operatorëve Ekonomik STUDIO HAPSIRA SH.P.K.; SEMAKS SH.P.K.; DEA GROUP SH.P.K.; GEOPLAN&CONSULTING GROUP SH.P.K me çmimin njësi të poentuar 0.86 euro

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit të intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

Bashkëngjitur me këtë letër është kontrata.

Bashkangjitur: Kontrata

Me respekt,
Fadil Sinani

Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit

U-V

[Nënshkrimi]

¹² Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata

¹³ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

B46 - Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm ¹⁴

Datë: 28.07.2026

Kuvendi Komunal-Dragash

PROing&Partners SH.P.K.; GEOCAD Group SH.P.K

Nr. i prokurimit ¹⁵	621-26-4068-2-2-1
Nr i brendshëm	621-26-021-2-2-1

Titulli: 021-Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës së Dragashit-24 Muaj

I/e nderuar(a) [Z/Znj]

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP". Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kriterëve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj *[nuk qe më i favorshmi nga aspekti ekonomik]* **[nuk qe tenderi me çmimin më të ulët,]** në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Ju informojmë se kontrata i është dhënë:

Grup i Operatorëve Ekonomik STUDIO HAPSIRA SH.P.K.; SEMAKS SH.P.K.; DEA GROUP SH.P.K.; GEOPLAN&CONSULTING GROUP SH.P.K me çmimin njësi të poentuar 0.86 euro

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimin e intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*


Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Fadil Sinani

[Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

U-D



[Nënshkrimi]

¹⁴ Kjo letër u drejtohet tenderuesve që i kanë plotësuar të gjitha kërkesat e autoritetit kontraktues, të paraqitura në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, por të cilëve nuk u është dhënë kontrata, ngase tenderët e tyre nuk qenë nga më të mirët sipas kriterit për dhënien e kontratës.

¹⁵ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:	621-26-4068-2-2-1	Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru	021-Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës së Dragashit-24 Muaj
Numri i brendshëm Internal No Interni broj			

Data e lëshimit Date of issue Datum izdavanja	Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto	Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders Br. Primljenih Tendera
29.06.2026	29.06.2026, 13:30:00	29.06.2026, 13:30:00	Objekti i Komunës Dragash, zyra nr.8	3

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshimi/plotësimi Suplement/Amendment Dpuna/Izmjena
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik PROing&Partners SH.P.K.; GEOCAD Group SH.P.K., K.e Diellit Major M. Bushi Lam.12/11 Z. Perëndimi, 10000, Prishtinë	ODRG/012026	021-Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës së Dragashit-24 Muaj	PO	35.21	41.55	JO
2.	ENG IDEA SH.P.K., Brigada 123, 23000, Suhareke	2906	021-Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës së Dragashit-24 Muaj	PO	15.58	18.38	JO
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik STUDIO HAPSIRA SH.P.K.; SEMAKS SH.P.K.; DEA GROUP SH.P.K.; GEOPLAN&CONSULTI	621-26-4068-2-2-1	021-Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës së Dragashit-24 Muaj	PO	0.73	0.86	JO

	NG GROUP SH.P.K., MATI 1, 10000, PRISHTINË						
--	--	--	--	--	--	--	--

[Ne rast se kriteri i shpërblimit të kontratës është **Çmimi më i ulët**] [If the contract award criterion is **the lowest price**] [Ako je kriterijum za dodelu ugovora **Najniža cena**]
 [ÇMIMET PËR NJËSI, kurdo që është e mundur varësisht prej numrit të tendereve të dorëzuar, pozicioneve/artikujve, dhe pjesëve/loleve. Kjo të vendoset nga AK]
 [The unit prices, whenever possible depending on the number of tenders submitted, items / articles, and parts / lots. The CA decides]
 [CENE PO JEDINICI, uvek kada je moguće u zavisnosti od broja podnetih tendera, pozicija/artikala, i delova/lotova. Ovo će odlučiti UA]

Tenderuesi Tenderer Ponudáč	Pjesa Lot Deo	[Çmimi për Njësi] [Unit Price] [Cena po jedinici]							
		Art. 1	Art. 2	Art. 3	Art. 4	Art. 5	Art. 6	Art. n	Art. n+1
1	1								
	2								
	n								
2	1								
	2								
	n								
3	1								
	2								
	n								

[shto ose fshij rreshta sipas nevojës në këtë tabelë. Fshij komplet nëse aplikohet Tenderi ekonomikisht më i favorshëm]
 [Add or delete rows as needed in this table. Delete it completely if most economically advantageous tender]
 [dodaj ili izbriši redove po potrebi u ovoj tabeli. Izbriši celu tabelu ako se primenjuje ekonomski najpovoljniji tender]

[Ne rast se kriteri i shpërblimit të kontratës është **Tenderi ekonomikisht me i favorshëm**] [If the contract award criterion is **most economically advantageous tender**] [Ako je kriterijum za dodelu ugovora **Ekonomski najpovoljniji tender**]

Tenderuesi Tenderer Ponudač	Pjesa Lot Deo	Afati i liferimit në ditë Delivery time Datum isporuke	Garancia Guarantee Garancija	Etj Etc Ltd.	Etj Etc Ltd.	Etj Etc Ltd.
1	1					
	2					
	3					
2	1					
	2					
	3					
3	1					
	2					
	3					

[shto ose fshij rreshta sipas nevojës në këtë tabelë. Fshij komplet nëse aplikohet tenderi me çmimin me te ulet]

[Add or delete rows as needed in this table. Delete it completely if lowest price tender]

[dodaj ili izbriši po potrebi u ovoj tabeli. Izbriši celu tabelu ako se primenjuje tender sa najnižom cenom]

Komente nga përfaqësuesit e pranishem



Comments from the present authorized representatives of the CA and the EO at the opening of tenders:

Komentari prisutnih ovlaštenih predstavnika UA i EO na postupak otvaranja ponuda

Përfaqësuesi i OE / EO Representative / Zastupnik EO

Nr. Br	Tenderuesi, Emri / Mbiemri Tenderer, Name / Surname Tenderer, Ime / Prezime	Nënshkrimi Signature Potpis

Komisioni i hapjes / Opening commission / Komisija otvaranja

Emri Mbiemri Name Surname Ime Prezime	Nënshkrimi/ Signature/ Potpis	Datë/ Date/ Datum
FADIL SINANI		29/06/2026
SHENASI QAFLESHI		29/06/2026

Nënshkrimi i Zyrtarit të Prokurimit/ Procurement Officer Signature/ Potpis službenika za javne nabavke:

FADIL SINANI



*Procurement officer shall appoint a tender opening commission.

REGJISTRI I TENDERËVE TË DORËZUAR / TENDER SUBMISSION RECORD / REGISTAR PRIMLJENIH TENDERA

Numrin e prokurimit / Broj nabavke / Procurement number: 621-26-4068-2-2-1

Numri i brendshem / Interni broj / Internal No:

Lënda e prokurimit / Naziv nabavke / Title of the procurement: 021-Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës së Dragashit-24 Muaj

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer Name Tenderer	Pranimi i tenderit Tender Reception Prijem tendera	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Ndryshimi/plotësimi Suplement/Amendment Dpuna/Izmjena
1	Grup i Operatorëve Ekonomik PROing&Partners SH.P.K.; GEOCAD Group SH.P.K.	28.06.2026 15:31	ODRG/012026	
2	ENG IDEA SH.P.K.	29.06.2026 12:52	2906	
3	Grup i Operatorëve Ekonomik STUDIO HAPSIRA SH.P.K.; SEMAKS SH.P.K.; DEA GROUP SH.P.K.; GEOPLAN&CONSULTING GROUP SH.P.K.	29.06.2026 13:24	621-26-4068-2-2-1	

Nënshkrimi i Zyrtarit të Prokurimit/ Procurement Officer Signature/ Potpis službenika za javne nabavke:



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1034

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së (OE) “ARHIKO .ING” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “Komuna e Prizrenit” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve të ndryshme ideore dhe kryesore për ndërtim dhe renovim të objekteve sipas nevojave të DPMS në Komunën e Prizrenit” me numër të prokurimit 622-23-10883-2-2-1, me 07/02/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE “ARHIKO .ING” SH.P.K., me nr. 2023/1034 , e datës 19/12/2023, kurse vendimi i AK “Komuna e Prizrenit” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve të ndryshme ideore dhe kryesore për ndërtim dhe renovim të objekteve sipas nevojave të DPMS në Komunën e Prizrenit” me numër të prokurimit 622-23-10883-2-2-1.
2. **Anulohet** njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve të ndryshme ideore dhe kryesore për ndërtim dhe renovim të objekteve sipas nevojave të DPMS në Komunën e Prizrenit” me nr. të prokurimit: 622-23-10883-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Komuna e Prizrenit”, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 09.10.2023, "Komuna e Prizrenit" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Hartimi i projekteve të ndryshme ideore dhe kryesore për ndërtim dhe renovim të objekteve sipas nevojave të DPMS në Komunën e Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-23-10883-2-2-1. Ndërsa me datën 05.12.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE "STUDIO HAPSIRA SH.P.K"

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbimë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës **25,000,00 €**

Me 08.12.2023, OE "ARHIKO .ING" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. 12.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 19.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "ARHIKO .ING" SH.P.K., me nr. 1034/23 për lidhur me aktivitetin "Hartimi i projekteve të ndryshme ideore dhe kryesore për ndërtim dhe renovim të objekteve sipas nevojave të DPMS në Komunën e Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-23-10883-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "ARHIKO .ING" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i OE ankues: "Të nderuar ne me datën 05.12.2023 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-se. Pas qasjes ne dokumente zyrtare ne e kemi te paqarte se si AK ka shpallur fitues një OE i cili është dashur të eliminohet nga procedura e prokurimit pasi që çmimet e ofruara janë çmime jo normalisht të ulëta.

Pasi që në pozicionin. Shpimet Gjeomekanike - elaborati - llog. për 1m me te gjitha fazat -me njësi m' është çmimi 0.05-. Duke e analizuar bashkëpunimin tonë me shume kompani të cilat kryejnë këtë shërbim është e pamundur që një metër gjatësi me të gjitha fazat të kushtoj 0.05cent. Ndërsa çmimet në vendin tonë për këtë shërbim çmimi minimal është 50 Euro.

Ku të bashkangjitur do e gjeni edhe një fature tatimore të shërbimit të tillë të ofruar nga një kompani e cila kryen këto punë ne lokacionin e shërbimit i cili është K. Prizrenit. Ku çmimi i tillë është 50 Euro për 1m', ndërsa OE i shpallur i përgjegjshëm ka ofruar çmimin 0.05cent qe i bie 1,000% me lirë sesa çmimi real qe ofrohet ne vendin tonë dhe me këtë AK, nuk ka bere kërkesë për sqarim të dosjes se tenderit, për arsye se është ditur qe automatikisht do të eliminohet nga procedura e vlerësimit, dhe me këtë mendojmë qe Z. Prokurimit është e përfshirë ne kurdisjen e tenderit. Si dhe çmimet e tjera ku ne tabelën me poshtme mund të gjeni edhe një analitik të çmimeve të ofertuara nga “kompania që është shpallur fituese” dhe çmimet e kompanisë sonë.

Ne në një procedurë të ngjashme të prokurimit Titulli: Hartimi i projektit për kolektorët kryesorë të Qytetit të Prizrenit me numër te prokurimit: 622-22-2389-2-2-1 kemi konkurruar tek ju si Autoritet Kontraktues ku çmimet e ofruara nga ana jonë pavarësisht se nga ana jonë nuk kanë qenë të tilla dhe kanë qenë çmime të tregut ju na keni eliminuar ndërsa për këtë procedurë të procedurë të tenderimit siç po shihet e paskeni harruar Çmimin jo normalisht të ulët. Sipas Nenit 41 te LPP-se dhe nenit 41.6. Ku Komisioni i vlerësimit është dashur që të shikoj çmimet e ofertuara dhe jo të shpall te përgjegjshëm një OE i cili ka ofruar çmime të cilat janë çmime jo normalisht të ulëta. Pasi qe eliminimi ynë ne këtë procedure të lartcekur Hartimi i projektit për kolektorët kryesorë të Qytetit të Prizrenit është bërë me pretendimin se janë çmime jo normalisht të ulëta ndërsa ne këtë procedure nuk po vlejtkja ky ligj. Çmimin jo normalisht të ulët. Sipas Nenit 41 të LPP-së dhe nenit 41.6.

Duke e pare favorizimin qe është bere ne këtë procedure të tenderimit tek ne lind vetëm dyshimi qe kjo procedure e tenderimit është një procedure e cila është proceduar për një operatore ekonomik, si dhe lindin dyshimet për bashkëpunim ne mes të operatorit ekonomik të shpallur fitues si dhe zyrtareve te prokurimit, pasi qe ne si kompani kemi ofruar çmimet te cilat janë çmime të tregut të cilat i shihni edhe me lartë të analizuar dhe diferencën e tyre, kurse çmimet e ofruara nga operatori ekonomik ne fjale, lindin dyshimet se si do të kryhen këto shërbime, me qfarë profesionalizmi apo është e kurdisur edhe paramasa që të punohet një pozicion ku OE i shpallur fitues ka çmim më të favorshëm duke e përfshirë edhe njësinë kërkuese të hartimit të paramasave”.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “ARHIKO .ING” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 41, 41.6, 59, dhe 64 të LPP-së , Udhëzues Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik-8. Kriteret e përzgjedhjes. Duke propozuar qe ankesa të Aprovohet, si e bazuar Ankesa e kompanisë sonë të Anulohet, njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe lënda të kthehet në Rivlerësim, dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të bëhet siç e parashikon ligji nga profesionist të kësaj lëmie dhe rivlerësimi të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: OE “Arhiko Ing” SHPK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve të ndryshme ideore dhe kryesore për ndërtim dhe renovim të objekteve sipas nevojave të DPMS në Komunën e Prizrenit” me nr të Prok: 622-23-10883-2-2-1 Autoriteti Kontraktues, me dat. 12. 12. 2023

, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka vendosë që kërkesa juaj për rishqyrtim të refuzohet si e pa bazuar për arsyet në vijim:

Komisioni për vlerësim të ofertave të këtij projekti, ka analizuar të gjitha çmimet edhe për pozicione të ofruara nga të gjith OE pjesmarrës në këtë projekt, por edhe të OE të propozuar për kontratë dhe ka ardhë në përfundim se çmimet e ofruara për njësi të OE të propozuar për kontratë janë në rregull.

Edhe në procesin e rishqyrtimit të kërkesës tuaj, AK ka analizuar pretendimet tuaja dhe mbetet në rekomandimin e komisionit, por nëse në procedurat e mëtejme AK do të vijë në përfundim se OE me çmimet e ofruara nuk do të mund të përmbyllë me sukses kontratën, AK do të kërkoj rritje të sigurisë së ekzekutimit nga 10 % sa është tani, në 30 % .”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 26.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1034/23, ndërsa me datë 04.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/1034 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Nuk Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtuese, ndërsa OE ka deklaruar pajtohemi me mendimin e ekspertit .

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “ARHIKO .ING” SH.P.K., - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1034. ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimin ankimor 1: “Duke e analizuar bashkëpunimin tonë me shumë kompani të cilat kryejnë këtë shërbim është e pamundur që një metër gjatësi me të gjitha fazat të kushtoj 0.05cent. Ndërsa çmimet në vendin tonë për këtë shërbim çmimi minimal është 50 Euro.

Ku te bashkangjitur do e gjeni edhe një fature tatimore të shërbimit të tillë të ofruar nga një kompani e cila kryen këto punë ne lokacionin e shërbimit i cili është K. Prizrenit. Ku çmimi i tillë është 50Euro për 1m’, ndërsa OE i shpallur i përgjegjshëm ka ofruar çmimin 0.05cent qe i bie 1,000% me lire sesa çmimi real qe ofrohet ne vendin tone dhe me këtë AK, nuk ka bere kërkesë për sqarim te dosjes se tenderit, për arsye se është ditur qe automatikisht do te eliminohet nga procedura e vlerësimit, dhe me ketë mendojmë qe Z. Prokurimit është e përfshirë ne kurdisjen e

tenderit.”

Përgjigjja ne pretendim 1: “Sa i përket këtij pretendimi për çmime jo normalisht të ulëta si ekspert konstatoj se këtu Komuna e Prizrenit nuk i ka respektuar procedurat ligjore që parasheh ligji dhe RRPP neni 41.1 për sqarime për çmime jo normalisht të ulëta. Ne Aktivitetin e Prokurimit të lart cekur problemi themeltare është se AK nuk ka pasur vullnetin ti trajtoj OE si çmime jo normalisht të ulët por ka rekomanduar OE me çmim me të ulët.

Në bazë të nenit 61 të LPP-së nuk mundet as të rekomandoj por as të refuzoj pa e bere një hetim dhe shqyrtim të çmimeve jo normalisht të ultë dhe të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara se si ka ardhur deri të çmimet jo normalisht të ulëta ne bazë të kësaj konstatoj se nuk është bërë shqyrtimi i çmimeve .

Çmimi që është cekur ne ofertë për ekspertin shqyrtues janë çmime që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese dhe shumë të dyshimta që këtë mundem me konstatuar se nuk mundet të implementohet kontrata ne tersi. AK-ja këtë OE e ka favorizuar kur ka rekomanduar për kontratë, gjithashtu duke u bazuar ne tenderin e shpallur ne vitin korrik 2022 (Hartimi i projekteve sipas nevojave të drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Prizrenit nr. Prokurimit Nr. 622-22-7011-2-2-I; Nr. i brendshëm 6622-22-070-221 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal i Prizrenit) ka ofertuar me çmim jo normalisht të ultë e për mua si ekspert mendoj që është i favorizuar ky OE dhe AK-ja ka bere diskriminim dhe ka shkelur parimet e themelore të Prokurimit duke favorizuar çdo here këtë OE, kështu që pretendimet ankimore janë të bazuar.

Lind pyetja a është e mundur që ky OE me çmime 0.05 € me realizuar një kontratë me këtë çmim , “jo” atëherë unë mendoj se personat përgjegjës të AK-së mundet të këtë bashkëpunime me OE apo me ndonjë zyrtar të AK-se pasi shihet se është favorizuar ne dy aktivitet, ne baze të nenit 130 të LPP-së çdo person i AK-se ose zyrtar nëse vetëm pak ka ndikim lidhur me këtë aktivitet të prokurimit duhet të veprojnë sipas nenit 130 paragrafi 3. Gjithashtu AK ne baze të nenit 70.24 e RRPP menaxheri i kontratës nuk mundet të siguroj se do të menaxhohet dhe kontrollohet kosto e shërbimeve, cilësisë, dhe kohës së shërbimeve me një çmim 0.05.

Unë si ekspert mendoj se komisioni i vlerësimit dhe menaxheri i prokurimit duhet të beje një krahasim të çmimeve që AK-ja ka bere -njësia e kërkesës ne DNDF, pra sa ka qene hulumtimi i tregut nga AK-ja për Shpimet gjeomekanike për një metër dhe nëse është një ndryshim i çmimit kaq i madh se çmimi i tregut atëherë duhet të eliminohet OE i rekomanduar për kontrate. Mirëpo nëse kërkesa e AK-së është jashtë çmimeve të tregut ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet.

Unë si ekspert mendoj edhe nëse do të ju dërgohet OE të rekomanduar që ta arsyetoj çmimin jo normalisht të ulët sipas nenit 61 të LPP-së se ky OE nuk mundet ta arsyetoj.

Duke u nisur nga RRPP 82/2022:

Nëse një OE do të llogarit vetëm disa elementet që lidhen me rregullat për sigurinë, kushtet e punës siç kërkohet me ligjet e punës përgatitja e punishtes rrethoja etj etj, atëherë mundem me

konstatuar se çmimi është jo normalisht i ulët dhe te gjitha këto munden te merren për të refuzuar një tender jo-normalisht të ulët.

Rekomandimi im është se komisioni i vlerësimit i AK-së gjatë fazës se vlerësimit ka mundur ti kërkoj OE të rekomanduar për kontratë një fatuar të rregullt për muajt qershor, korrik dhe gushte të lëshuar nga kompanitë që merren Shpimet gjeomekanike për një metër , në bazë të kësaj atëherë kanë munder me bere një vlerësim real të ofertave dhe me berë krahasimin e çmimit që e kane ofertuar 0.05 €.

Info për panelin: Sipas llogaritjes time nëse kemi mi bere ; Shpime gjeomekanike 100 m X 0.05 çmimi i OE = 5 €. Si qe shihet me 5 € me u bere 100 m Shpimet gjeomekanike kjo nuk mundet askund të ndodhe por kjo është vetëm një mashtrim qe OE ka bere AK-se.

Duke u bazuar ne sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtuese i propozon panelit shqyrtuese qe ankesa e OE ankues te aprovohet si e bazuar, te anulohet njoftimi për dhënie te kontratës dhe rekomandon qe lënda te kthehet ne rivlerësim.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ARHIKO .ING” SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues është mbështetur në raportin e ekspertit shqyrtues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ARHIKO .ING” SH.P.K., janë të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Hartimi i projekteve të ndryshme ideore dhe kryesore për ndërtim dhe renovim të objekteve sipas nevojave të DPMS në Komunën e Prizrenit” me nr. të prokurimit: 622-23-10883-2-2-1.

Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ARHIKO .ING” SH.P.K., dhe se, Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit.

Theksojmë se sa i përket pretendimit për çmimin jo normalisht të ulët Komuna e Prizrenit nuk i ka respektuar procedurat ligjore qe parasheh ligji dhe RRPP neni 41.1 për sqarime për çmime jo normalisht të ulëta. Ne Aktivitetin e Prokurimit të lart cekur AK nuk ka trajtuar OE si çmime jo normalisht të ulët por ka rekomanduar OE me çmim me të ulët .Në bazë të nenit 61 të LPP-së

nuk mundet as të rekomandoj por as të refuzoj pa e bere një hetim dhe shqyrtim të çmimeve jo normalisht të ultë dhe të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara se si ka ardhur deri të çmimet jo normalisht të ulëta ne bazë të kësaj konstatojmë se nuk është bërë shqyrtimi i çmimeve . Po ashtu, AK në fazën e ri-vlerësimt të bëjë një hulumtim të tregut në mënyrë që të krahasoj se çmimet e ofruara në pozicione nga ana e ofertuesëve a janë të përafërta me ato të tregut.

- Përfundim-

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i projekteve të ndryshme ideore dhe kryesore për ndërtim dhe renovim të objekteve sipas nevojave të DPMS në Komunën e Prizrenit” me nr. të prokurimit: 622-23-10883-2-2-1. , të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës , ankesën e operatorit e sheh si të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me “Hartimi i projekteve të ndryshme ideore dhe kryesore për ndërtim dhe renovim të objekteve sipas nevojave të DPMS në Komunën e Prizrenit” me nr. të prokurimit: 622-23-10883-2-2-1. , të rivlerësohet AK të veprojnë në raport me dispozitat ligjore të LLP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetin e prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të ushtrojë Padi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit në Gjykatës Komerciale/Departamentit për çështje Administrative në Prishtinë.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- **OE - ARHIKO .JING SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së:



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0431

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim, paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) ARHIKO .ING SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Hartimi i projekteve të ndryshme për objektet shkollë -për nevojat e DKA Prizren me numër të prokurimit 622-24-1861-2-2-1, me 03/07/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE ARHIKO. ING SH.P.K-Prishtinë me nr. 2024/0431 , e datës 17/05/2024, kurse vendimi i AK KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT lidhur me aktivitetin e prokurimit Hartimi i projekteve të ndryshme për objektet shkollë -për nevojat e DKA Prizren me numër të prokurimit 622-24-1861-2-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Ri-vlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Në përputhje me Rregulloren e Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues ARHIKO. ING SH.P.K Prishtinë, i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 05.03.2024 Komuna e Prizrenit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Hartimi i projekteve të ndryshme për objektet shkollore -për nevojat e DKA Prizren me nr. te prokurimit: 622-24-1861-2-2-1”. Ndërsa me datë 03.05.2024 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku është anuluar aktiviteti i prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 100,000.00€

Me 07.05.2024 OE “Arhiko Ing” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 10.05.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 17.05.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Arhiko Ing” me nr. 431/2024 lidhur me aktivitetin “Hartimi i projekteve të ndryshme për objektet shkollore -për nevojat e DKA Prizren me nr. te prokurimit: 622-24-1861-2-2-1”.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Arhiko Ing” janë parashtruar si në vijim:

Sqarim hyrës : “Të nderuar ne me datën 03.05.2024 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-se. Pasi që me datën: 07.02.2024-ne kemi pranuar edhe Vendimin e Panelit shqyrtues nr. 1034/23- ne një lënde për hartimin e projekteve ku edhe është trajtuar ne mënyrë profesionale çështja e çmimit për hartimin e elaboratit gjeomekanik. Pas qasjes ne dokumente zyrtare ne e kemi te paqarte se si AK ka shpallur fitues një OE i cili është dashur të eliminohet nga procedura e prokurimit pasi që çmimet e ofruara janë çmime jonormalisht të ulëta.”

Pretendimi i parë (I): “pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim të plotë me nenin 41.6 i rregullores për prokurim publik Nr.001/2022 dhe vendimin e PSH 1034/23 i datës 07.02.2024, kur ka rekomanduar për kontratë FST Engineering SH.P.K. i cili ka ofertuar me çmim prej 0.05

cent për pozicionin e 7 nën pika B “ Shpimet Gjeomekanike - elaborati - llog. për 1m”, kurse për pozicionin 11 tek nënpika C “ Dokumentacioni i nevojshëm/ Ilikekuar, për legalizimin e objekteve Arsimore, e kompletuar me të gjitha fazat, ka ofertuar me çmim prej 0,50 euro të dyja këto çmime jo-normalisht të ulëta. Po ashtu edhe Operatorët Ekonomik tjetër konkurrues si : Alb-Architect, për pozicionin e njëjtë ka ofertuar me çmim prej 0.50 e që është ab-normalisht i ulët, kurse për pozicionin 11 tek nënpika C “ Dokumentacioni i nevojshëm/ Ilikekuar, për legalizimin e objekteve Arsimore, e kompletuar me të gjitha fazat, ka ofertuar me çmim prej 1 euro, çmim ky ab-normalisht i ulët. OE, Pro Ing Partners SHPK, për pozicionin 11 tek nënpika C ka ofertuar me çmim prej ofruar një çmim prej 6.00Euro për përgatitjen e dokumentacionit që ky çmim mund të mbuloj printimet e kopjeve fizike por nuk mund të mbuloj çmimin e hartimit të elaboratit të zjarrit dhe raportet tjera duke e ditur që çmimet për elaborate të zjarrit dhe raporte të tjera në bazë të kërkesës nga MMPH është shumë më i lartë sesa ky çmim andaj AK është dashur të eliminoj këtë OE dhe jo të shpall të përgjegjshëm. OE, Dea Group SHPK, për pozicionin e 7 nën pika B “ Shpimet Gjeomekanike - elaborati - llog. për 1m”, ka ofertuar me çmim prej 25€ Ndërsa çmimet në vendin tonë për këtë shërbim çmimi minimal është 50 Euro. OE, GeoPlan për pozicionin e 7 nën pika B “ Shpimet Gjeomekanike - elaborati - llog. për 1m”, ka ofertuar me çmim prej 25€ Ndërsa çmimet në vendin tonë për këtë shërbim çmimi minimal është 50 Euro.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Arhiko Ing” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 1, 7, 41, 59, 64 të LPP-së si dhe neni 8 i Udhëzues Nr.001/2023 për Prokurimin Publik. Duke u bazuar në dëshmitë dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga ana juaj si OSHP që të merr: VENDIM Apropohet, si e bazuar Ankesa e kompanisë sonë Anulohet, njoftimi mbi vendimin e AK-së për vlerësimin e fazës së parë të projekti të lënda të kthehet në Rivlerësim, dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të bëhet siç e parashikon ligji nga profesionist të kësaj lëmie dhe rivlerësimi të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: “Komisioni për vlerësim të ofertave të këtij projekti, ka analizuar të gjitha çmimet edhe për pozicione të ofruara nga të gjithë OE pjesëmarrës në këtë projekt, por edhe të OE të propozuar për kontratë dhe ka ardhë në përfundim se çmimet e ofruara për njësi të OE të propozuar për kontratë janë në rregull (pra komisioni i dhe zyra e prokurimit nuk i konsiderojnë këto çmime si jonormalisht të ulta). Edhe në procesin e rishqyrtimit të kërkesës tuaj, AK ka analizuar pretendimet tuaja dhe mbetet në rekomandimin e komisionit, por nëse në procedurat e mëtejme AK do të vijë në përfundim se OE me çmimet e ofruara nuk do të mund të përmbyllë me sukses kontratën, AK do të kërkojë rritje të sigurisë së ekzekutimit nga 10 % sa është tani, në 30 % . Andaj duke u mbështetur në këto fakte. Autoriteti Kontraktues, vendos si në diapozitivin e këtij vendimi.”

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 21/05/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 431/2024, ndërsa me datë 29/05/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/431 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në

sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK Nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtues, OE është pajtuar lidhur me mendimin e ekspertit .

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Arhiko Ing” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/431 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): “Eksperti shqyrtues sqaron se, AK nuk kishte kërkuar fare sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë, dhe OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet prokurimi lidhur me çmime ab-normalisht të ulëta para se ta rekomandojë për kontratë në mënyrë që të sigurohet e oferta e OE të rekomanduar dhe OE tjerë konkurrense të vlerësuara si oferta të përgjegjshme me të vërtetë pëmbajnë apo jo çmime jonormalisht të ulëta. Më tej eksperti shqyrtues sqaron se, në rastin konkret konsideroj se, AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 41.6 i rregullores për prokurim publik Nr.001/2022 dhe vendimin e panelit PSH 1034/23 i datës 07.02.2024, kur ka rekomanduar për kontratë FST Engineering SH.P.K sepse vërehet që oferta e dorëzuar sa i përket pozicionit 7 nën pika B “ Shpimet Gjeomekanike - elaborati - llog. për 1m”, përmban çmim jo normalisht të ulët. AK kishte vepruar njësoj edhe në rastin kur i ka vlerësuar ofertat e Operatorëve Ekonomik: “Pro Ing Partners SHPK;Dea Group SHPK;Alb-Architect dhe GeoPlansi të përgjegjshme pa kërkuar sqarime shtesë pasi që në disa pozicione vërehet se ofertat e operatorëve ekonomik të lartë shënuar përmbajnë çmime ab-normalisht të ulëta. Neni 41.6 i rregullores për prokurim publik Nr.001/2022 “ Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo normalisht i ulët sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbatim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo normalisht të ulët”. Eksperti shqyrtues, po ashtu sqaron se mbetet në përgjegjësi dhe diskrecion të Autoritetit kontraktues, respektivisht

komisionit të vlerësimit (ZPP-së) që vlerësimi i ofertave, të bëhet në harmoni të plotë me nenin 59 paragrafi 4 dhe nenin 41 i rregullores për prokurim publik nr. 001/2022 në atë mënyrë që lejonë trajtim të barabartë dhe të arrihet qëllimi i LPP-se dhe vlera për parën. Si përfundim, Eksperti shqyrtues rekomandon që AK gjatë ri-vlerësimit të ofertave të përmbahet në përpikëri nenit 59 paragrafi 4 të LPP-së dhe nenit 46.1 të rregullores për prokurim publik nr. 001/2022 dhe të kërkojë sqarime shtese tek operatorët ekonomik në mënyrë që të konstatohet përmbajtja financiare e ofertave se a janë ab-normalisht të ulëta apo të larta si dhe vendimit të panelit PSH 1034/23 i datës 07.02.2024. Andaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se edhe pretendimet e palës në ankesë janë të qëndrueshme.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Arhiko Ing” Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Arhiko Ing” janë të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Hartimi i projekteve të ndryshme për objektet shkollore -për nevojat e DKA Prizren me nr. të prokurimit: 622-24-1861-2-2-1”. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Arhiko Ing” dhe se, Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Arhiko Ing” janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i projekteve të ndryshme për objektet shkollore -për nevojat e DKA Prizren me nr. të prokurimit: 622-24-1861-2-2-1” të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe

dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit e sheh si të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me “Hartimi i projekteve të ndryshme për objektet shkollore -për nevojat e DKA Prizren me nr. te prokurimit: 622-24-1861-2-2-1”, të ri-vlerësohet AK të veproj në raport me dispozitat ligjore të LLP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të argumenteve të paraqitura në përshkrimin e çmimeve dhe raportit të ekspertit shqyrtues, ka vlerësuar se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e operatorit ekonomik "Arhiko Ing". Në harmoni me Ligjin për Prokurim Publik të Kosovës, veçanërisht në bazë të nenit 41.6 të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022, dhe vendimit të Panelit Shqyrtues 1034/23, Paneli ka konstatuar se AK ka vepruar në kundërshtim me këto dispozita duke pranuar ofertë me çmime jo-normalisht të ulëta në shumë pozicione e të cilat janë të evidentuara në Përshkrim të Çmimeve. Si rezultat, Paneli Shqyrtues ka vendosur që Ankesa e operatorit ekonomik "Arhiko Ing" të aprovohet si e bazuar. Njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënien e kontratës të anulohet, dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në diapozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- **OE - ARHIKO .JNG SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së:



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0674

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga zv.Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim, paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së OE “Arhiko.Ing Sh.P.K.”, kundër Mosekzekutimi i vendimit të OSHP-së lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve të ndryshme për objektet shkollore -për nevojat e DKA Prizren” me numër të prokurimit 622-24-1861-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna e Prizrenit, më 25/09/2024, mori këtë:

Vendim

1.Aprovohet, si e bazuar ankesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik “Arhiko.Ing Sh.P.K.”, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 26.07.2024 (me numër protokolli 0674/2024) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve të ndryshme për objektet shkollore - për nevojat e DKA Prizren” me numër të prokurimit 622-24-1861-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, Komuna e Prizrenit.

2.Të Anulohet, B58 Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhanje të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve të ndryshme për objektet shkollore -për nevojat e DKA Prizren” me numër të prokurimit 622-24-1861-2-2-1, e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prizrenit ndërkaq aktiviteti i prokurimit i lartë përmendur kthehet në rivlerësim.

Arsyetim

-Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: OE “Arhiko Ing” SHPK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve të ndryshme për objektet shkollore për nevojat e DKA së në Prizren” me nr. të Prok: 622-24-1861-2-2-1.

Autoriteti Kontraktues, me date 22. 07. 2024 , ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka vendosë që kërkesa juaj për rishqyrtim të refuzohet si e pa bazuar për arsytet në vijim: Procesi i rivlerësimit të ofertave është bërë në përputhje të plotë me vendimin e OSHP së Vendimi 2024/ 0431 i datës 03. 07. 2024, me të cilin vendim kërkohet nga AK që edhe një herë të rishqyrtoj çmimet me të cilat ka ofertuar OE i propozuar për kontratë. 1. Komisioni ka hulumtuar çmimet e ngjashme për shërbimet e kërkuara në DT dhe NJK, dhe ka konstatuar se këto çmime janë në kuadër të mesatares së çmimeve me të cilat kryhen këto shërbime. 2. Askund dhe në asnjë nen të LPP së dhe të Rregullores për prokurim publik nuk shkruan se pas kthimit të lëndës në rivlerësim, AK duhet të formoj komision të ri, pra zyrtari i prokurimit ka vendos që rivlerësimin të ia besoj të njëjtit komision dhe as këtu nuk ka kurrfarë shkelje të pretenduara nga ju. 3. Me datë 03. 07. 2024 nga zyra e prokurimit, përmes platformës së E prokurimit, është kërkuar nga ana e OE pjesëmarrës në këtë proces që të bëjnë zgjatjen e vlefshmërisë së ofertave, dhe këtë veprim e kane bërë të gjithë pjesëmarrësit, andaj në këtë proces nuk kemi palë pa interes, (ky është zbulim i juaj dhe ne nuk e mbështesim këtë teori). 4. Se AK ka qen dhe do të jetë korrekte deri në fund lidhur me këtë proces, flet edhe fakti se ne po e mbrojmë ofertën e përgjegjshme me çmimin më të ulët. Po të ishte e kundërta që fitues të shpallen ju që e keni ofertën më të lartë se të gjithë tjerët, atëherë do të vihej në dyshim korrektësia e zyrtarit të prokurimit, dhe e tërë stafit i cili është marr me këtë projekt. 5. Ne mbetemi te konstatimi se nëse OE me çmimet e ofruara nuk do të mund të përmbyllë me sukses kontratën, AK do të kërkoj rritje të sigurisë së ekzekutimit nga 10 % sa është tani, në 30 %.

Përgjigje e ekspertit shqyrtues në pretendimet ankimore të OE “Arhiko .Ing Sh.P.K.”:

OE ankues në ankesën e parashtruar në OSHP ka ngritë pretendime ankimore të cilat paraprakisht përmes vendimit PSH 1034/23 i datës 07.02.2024 dhe vendimit PSH 2024/0431 i datës 03.07.2024 ishin trajtuar dhe janë konsideruar si të bazuara, nga AK ishte kërkuar që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim dhe të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK, ku ishte rekomanduar për kontratë OE “FST Engineering SH.P.K. i cili ka ofertuar me çmim prej 0.05 cent për pozicionin e 7 nën pika B “Shpimet Gjeomekanike - elaborati - llog. për 1m”, kurse për pozicionin 11 tek nënpika C “Dokumentacioni i nevojshëm/ i kërkuar, për legalizimin e objekteve Arsimore, e kompletuar me të gjitha fazat, ka ofertuar me çmim prej 0,50 euro të dyja këto çmime jo-normalisht të ulëta. Konstatimet për aprovim të pretendimeve ankimore si të bazuara janë sikur në ekspertizat me nr. 1034/23 dhe 2024/0431 si dhe në vendimet e Panelit Shqyrtues me nr. PSH 1034/23 i datës 07.02.2024 dhe vendimi 2024/0431 i datës 03.07.2024. Për faktin që vendimet kanë rezultuar me ri-vlerësim nënkupton se pretendimet ankimore kanë qenë të bazuara dhe AK ka pas për obligim që ti evitoj shkeljet e konstatuara në raportet e ekspertizave dhe të vendimet e PSH-se, të cekura më lartë dhe ti korrigjoj ato përmes rivlerësimit të ofertave. Pavarësisht kësaj AK nuk ka ndryshuar rezultatin me rastin e ri-vlerësimit dhe njëkohësisht nuk ka zbatuar vendimet e OSHP-se pasi që AK nuk ka kërkuar fare sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë, dhe OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet prokurimi lidhur me çmime ab-normalisht të ulëta, ashtu siç e ka obliguar vendimi i OSHP-së, por ka vazhduar duke rekomanduar për kontratë OE e njëjtë pa kërkuar sqarime shtesë sipas Nenit 41.6 i rregullores për prokurim publik Nr.001/2022 dhe vendimeve të OSHP-së.

Po ashtu sqaron se në kuptim të nenit 29 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së Autoriteti Kontraktues ka pas për obligim që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të njoftoj OSHP-në lidhur me rezultatin e procesit të rivlerësimit. Bazuar në nenin 16 Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2022 paragrafi 2, paneli shqyrtues konstaton se pretendimet ankimore janë të njëjta të cilat janë shqyrtuar edhe më parë nga ana e Panelit Shqyrtues andaj

çështja sa i për ketë pretendimit ankimor lidhur me çmimet ab-normalisht e ulët të trajtohet si “ Res- Judicata”.

Më tej pala në ankesë pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim të plotë edhe me nenin 28 pika 6 e rregullores për prokurim publik nr. 001/22, ku parashihet që siguria e tenderit duhet të jetë valide 30 ditë më shumë se sa afatit i vlefshmërisë së tenderit. Eksperti shqyrtues sqaron se në rastin konkret AK me dt. 04.07.2024 përmes platëformës elektronike e-prokurimi kishte kërkuar nga OE që të bëjnë zgjatjen e periudhës së validitetit të ofertave dhe të sigurisë së tenderit. OE i rekomanduar për kontratë me dt. 04.07.2024 përmes platëformës elektronike ka bashkangjitur deklaratën përmes të cilës konfirmon e vazhdon validitetin e ofertës për 120 ditë “Ne si OE pranojmë vazhdimin e vlefshmërisë së Ofertës për Kontratën me titull: “Hartimi i projekteve të ndryshme për objektet shkollore -për nevojat e DKA Prizren” me Nr. te prokurimit: 622-24-1861-2-2-1 Për 120 ditë sipas kërkesës së AK-së me date: 04.07.2024”. Po ashtu kishte bashkangjitur edhe sigurinë e tenderit me validitet nga data 25.07.2024 deri me dt.22.11.2024 apo për 120 ditë. Bazuar në deklaratën e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë me dt 04.07.2024 për zgjatje të validitetit të ofertës prej 120 ditëve është dashur që siguria e tenderit të zgjatet për periudhën prej 150 ditë që e njëjta të jetë në harmoni me nenin 28 pika 6 e rregullores për prokurim publik nr. 001/22 që obligon se siguria e tenderit duhet të jetë valide 30 ditë më shumë se sa validiteti i ofertës. “28.6 Sigurimi i tenderit do të qëndroj valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit”. Andaj konsideroj se deklarata për zgjatjen e periudhës së validitetit të ofertës dhe siguria e tenderit e dorëzuar së bashku me deklaratën nuk janë në harmoni me nenin e lartcekur te rregullores. Eksperti shqyrtues, po ashtu sqaron se mbetet në përgjegjësi dhe diskrecion të Autoritetit kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit (ZPP-së) që vlerësimi i ofertave, të bëhet në harmoni të plotë me nenin 59 paragrafi 4 dhe nenin 41 i rregullores për prokurim publik nr. 001/2022 të zbatohen vendimet e OSHP-së te cekura në rastin konkret në atë mënyrë që lejon trajtim të barabartë dhe të arrihet qëllimi i LPP-se dhe vlera për parën. Si përfundim, Eksperti shqyrtues sqaron se Paneli Shqyrtues, në vendimin PSH 2024/0431 të datës 03.07.2024 ka konstatuar se AK ka vepruar në kundërshtim me këto dispozita duke pranuar ofertë me çmime jo-normalisht të ulëta në shumë pozicione e të cilat janë të evidentuara në Përshkrim të Çmimeve. Si rezultat, Paneli Shqyrtues ka vendosur që Ankesa e operatorit ekonomik "Arhiko Ing" të aprovet si e bazuar. Njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënien e kontratës të anulohet, dhe lënda të kthehet në shqyrtimit të argumenteve te paraqitura ne përshkrimin e çmimeve dhe raportit të ekspertit shqyrtues, ka vlerësuar se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e operatorit ekonomik "Arhiko Ing". Në harmoni me Ligjin për Prokurim Publik të Kosovës, veçanërisht në bazë të nenit 41.6 të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022, dhe vendimit të Panelit Shqyrtues 1034/23, Paneli ri-vlerësim.

Andaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se edhe pretendimet e palës në ankesë janë të qëndrueshme dhe se ankesa të trajtohet si “ Res- Judicata” OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 01/08/2024 ka rekomanduar që:

- Të aprovet ankesa e OE ankues, si dhe
- Kjo çështje sipas ekspertit është çështje e gjykuar

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimeve paraprake të OSHP-së.

-Gjetjet e panelit shqyrtues-

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, panelit shqyrtues e vlerëson si të bazuar ankesën e OE ankues “Arhiko .Ing Sh.P.K.”. Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, Kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”.

Paneli shqyrtues sqaron se, OE ankues në ankesën e parashtruar në OSHP ka ngritë pretendime ankimore të cilat paraprakisht përmes vendimeve nr. 1034/2023 të lëshuar me datë 07.02.2024 dhe vendimit 0431/2024 të lëshuar me dt. 03.07.2024 ishin trajtuar dhe janë konsideruar si të bazuara, dhe sipas vendimeve të OSHP-se nga AK ishte kërkuar që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim dhe të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit. Konstatimet për aprovim të pretendimeve ankimore si të bazuara janë sikur në ekspertizën me nr. 1034/2023 dhe në vendimet e Panelit Shqyrtues me nr. 1034/2023 të lëshuar me datë 07.02.2023, dhe vendimit me nr. 0431/2024 të lëshuar me dt. 03.07.2024. Meqenëse vendimet kanë rezultuar me rivlerësim, nënkupton se pretendimet ankimore kane qenë të bazuara dhe AK ka pas për obligim që të evitoj shkeljet e konstatuara ne raport të ekspertizës, dhe ne vendimet e PSH-së dhe ti korrigjoj ato përmes rivlerësimit, por AK nuk ka ndryshuar rezultatin me rastin e ri-vlerësimit edhe pse në kuptim të nenit 29 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së Autoriteti Kontraktues ka pas për obligim që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të vendimit të njoftoj OSHP-në lidhur me rezultatin e procesit te rivlerësimit. Bazuar në nenin 16 të Rregullores se Punës se OSHP-së nr. 01/2022 paragrafi 2, Eksperti Shqyrtues konstaton se pretendimet ankimore janë të njëjta të cilat janë shqyrtuar edhe më parë nga ana e Panelit Shqyrtues dhe konsideroj se çështja të trajtohet si “ Res- Judicata”.

Pa nevojë për sqarime tjera shtesë, paneli shqyrtues bazuar në deklaratën e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë me dt 04.07.2024 për zgjatje të validitetit të ofertës prej 120 ditëve konstaton se është dashur që siguria e tenderit të zgjatet për periudhën prej 150 ditë që e njëjta të jetë në harmoni me nenin 28 pika 6 e rregullores për prokurim publik nr. 001/22 që obligon se siguria e tenderit duhet të jetë valide 30 ditë më shumë se sa validiteti i ofertës ;28.6 ‘‘ Sigurimi i tenderit do të qëndroj valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit”.

Paneli Shqyrtues thekson faktin se këto pretendime ankimore operatorit ekonomik OE ankues janë shqyrtuar me Vendimet PSh. nr.1034/2023 i lëshuar me date 07.02.2023, si dhe vendimi 0431/2024 i lëshuar me dt. 03.07.2024, andaj këto pretendime për panelin shqyrtues janë “Res Judicata” sipas nenit 16, pika 2 të Rregullores Nr.01/2020, e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit. Paneli shqyrtues sipas vendimit nr 0431/2024 , te datës : 03.07.2024 ka konstatuar se AK ka vepruar në kundërshtim duke pranuar ofertë me çmime jo-normalisht të ulëta në shumë pozicione e të cilat janë të evidentuara në Pershkrim të Çmimeve, ku AK-ja K.PRIZRENIT gjate ri-vlersimit te ofertave eshte dashur ta aplikoj nenin 41.6 të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022, lidhur me çmimet e ofruar, ku nje gjë të tillë nuk e ka aplikuar .

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Prizrenit që në tërësi të zbatohen dispozitat ligjore, dhe vendimet e PSH-së, në të kundërtën do ta detyrojë panelin shqyrtues që të respektoj nenin 131 të LPP-së, dhe njëkohësisht do të kërkojë nga KRPP-ja që ti anulojë certifikatën menaxherit të prokurimit të Autoritetit Kontraktues (AK) -Komuna e Prizrenit në pajtim me nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

Ky vendim është në përputhje me përpjekjet për të mbrojtur integritetin e procesit të prokurimit dhe për të siguruar që të gjitha ofertat të shqyrtohen në mënyrë të barabartë dhe të drejtë.

Nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- **OE - ARHIKO .JNG SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: